

## **Adelina Farrici**

Propozuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

Aktualisht është Drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore. Ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës ku u diplomua në vitin 1990, në degën e fizikës. Në vitin 2010 ka ndjekur studimet pasuniversitare në fushën e Administrimit Biznesit. Duke filluar nga viti 1990, për dy dekada radhazi, Farrici ka qenë e angazhuar në sistemin arsimor, ku fillimisht si mësuese dhe më tej drejtoreshë në disa institucione të arsimit parauniversitar.

Përgjatë gjithë udhëtimit profesional është angazhuar në projekte dhe trajnime kryesisht mbi të drejtat të grave, përfshirjes së komunitetit në proceset vendimmarrëse dhe përmirësimit të demokracisë lokale. Në vitin 2011, ajo u zgjodh kryetarja e parë grua në historinë e Bashkisë së Burrel-it, si një nga më njësitë më të rëndësishme të rrethit të Dibrës. Si kryetar bashkie, Farrici arriti të triumfojë mbi paragjykimet gjinore, duke inkurajuar figurën femërore në këtë rajon që të përfshihet më shumë në proceset vendimmarrëse.

Nga viti 2015 e në vazhdim, znj. Farrici është në postin e Drejtueses Ekzekutive të Shoqatës për Autonomi Vendore, shoqatë që përfaqëson të drejtat e qeverisjes vendore dhe angazhohet në zhvillimin e demokracisë lokale në vend.

Aktualisht ajo përfaqëson qeverisjen vendore në Komitete Drejtuese, Grupe ndër-institucionale dhe komisione për çështje të pushtetit vendor dhe është gjithashtu Sekretare e Delegacionit Kombëtar në Kongresin e Autoriteteve Rajonale dhe Lokale të Këshillit të Europës.

## **Adelina Farrici**

Proposed by the Agency for Support of Local Self-Government

Adelina Farrici currently serves as the Executive Director of the Association for Local Autonomy. She graduated in 1990 with a degree in Physics from the Faculty of Natural Sciences at the University of Tirana and pursued postgraduate studies in Business Administration in 2010.

From 1990 onward, she dedicated two decades to the education system, initially as a teacher and later as a director in various pre-university institutions. Throughout her professional journey, Farrici has been actively involved in projects and training focused on women's rights, community inclusion in decision-making processes, and improving local democracy. In 2011, she made history as the first female mayor of Burrel, one of the significant units in the Dibra district. As mayor, she successfully challenged gender biases, encouraging greater female participation in decision-making

processes within the region.

Since 2015, she has held the position of Executive Director of the Association for Local Autonomy, representing local governance rights and promoting the development of local democracy in Albania.

Currently, she represents local governance in Steering Committees, inter-institutional groups, and commissions on local government issues. She also serves as the Secretary of the National Delegation to the Congress of Local and Regional Authorities of the Council of Europe.